



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Kosova Cumhuriyeti



REPUBLIKA E KOSOVËS * REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURIYETI
Komuna e Prizrenit * Opština Prizren
Prizren Belediyesi
Kryetari i Komunës / Predsednik Opštine
Belediye Başkanı

01 Nr. 289/26 Dt. 01.07.2026



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren
Prizren Belediyesi

**Procesverbali nga mbajtja e takimit të Parë Publik të
kryetarit Shaqir Totaj me qytetarë për punën 6 mujore të
vitit 2026**

Në kuadër të transparencës dhe llogaridhënies ndaj qytetarëve, është hartuar procesverbali i Takimit të Parë Publik të Kryetarit të Komunës, Shaqir Totaj, me qytetarë, lidhur me raportimin e punës së realizuar gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2026. Ky takim ka pasur për qëllim informimin e drejtpërdrejtë të qytetarëve mbi aktivitetet, projektet dhe zhvillimet kryesore komunale, si dhe krijimin e një hapësire të hapur për diskutim dhe pyetje.

Procesverbali përmban përmbledhjen e plotë të rrjedhës së takimit, duke filluar nga hapja zyrtare, prezantimi i raportit të punës nga Kryetari i Komunës, e deri te diskutimet dhe pyetjet e parashtruara nga qytetarët dhe përfaqësuesit e pranishëm. Në të janë evidentuar temat kryesore të trajtuara, përfshirë projektet infrastrukturore, shërbimet publike, zhvillimin ekonomik dhe prioritetet e planifikuara për periudhën në vijim.

Gjithashtu, procesverbali pasqyron në mënyrë të saktë dhe objektive të gjitha qëndrimet, propozimet dhe shqetësimet e ngritura nga qytetarët, si dhe Përgjigjjaet dhe sqarimet e dhëna nga Kryetari dhe ekipi komunal. Ky dokument shërben si evidencë zyrtare e zhvillimit të takimit dhe garanton transparencë institucionale.

Në përmbyllje, procesverbali nënshkruhet nga përgjegjësit përkatës dhe arkivohet në përputhje me procedurat ligjore dhe administrative në fuqi, duke siguruar kështu dokumentim të rregullt dhe të qasshëm për institucionet dhe palët e interesuara.

Publikimet:

Publikimet janë bërë me **16:06.2026** në webfaqe zyrtare të komunës, në facebook-un e komunës, si dhe në platformën e konsultimeve publike:

Në webfaqe:

<https://prizren.rks-gov.net/wp-content/uploads/2026/06/Njoftim-per-orhanizimin-e-Takimit-te-Pare-Publik-me-qytetare-per-vitin-2026.pdf>

Njoftimi si lajm në webfaqe:

<https://prizren.rks-gov.net/news/kryetari-shaqir-totaj-fton-qytetaret-ne-takimin-e-pare-publik-per-vitin-2026/>

Facebook:

<https://www.facebook.com/share/p/1BmRAAtML8d/>

Memorandumi shpjegues:

<https://prizren.rks-gov.net/wp-content/uploads/2026/06/Memorandumi-shpjegues-per-organizimin-e-takimit-te-pare-publik-te-kryetarit-Shaqir-Totaj-me-qytetare-per-punen-6-mujore-2026.pdf>

Takimi është mbajtur në sallën e mbledhjeve të Kuvendit Komunal të Prizrenit dhe ka filluar në orën **10:12**.

Takimin publik me qytetarët për prezantimin e raportit të punës së Kryetarit të Komunës për gjashtëmujorin e parë të vitit 2026 e hapi Ymer Berisha, Udhëheqës i Njesisë për Komunikim me Publikun.

Në fjalën e tij hyrëse, ai u uroi mirëseardhje të gjithë pjesëmarrësve dhe i falënderoi qytetarët për praninë dhe interesimin e treguar për punën e institucioneve komunale. Ai theksoi se organizimi i takimeve publike është një mekanizëm i rëndësishëm për garantimin e transparencës, llogaridhënies dhe komunikimit të hapur me qytetarët.

Gjithashtu, nënvizoi se pjesëmarrja aktive e qytetarëve dhe bashkëpunimi i tyre me institucionet lokale kontribuojnë në identifikimin e nevojave të komunitetit, rritjen e cilësisë së vendimmarrjes dhe avancimin e zhvillimit të përgjithshëm të Komunës së Prizrenit. Në përfundim, ai ftoi të pranishmit që, përmes pyetjeve, sugjerimeve dhe komenteve të tyre, të japin kontributin e tyre në forcimin e një qeverisjeje transparente, gjithëpërfshirëse dhe të përgjegjshme.

Raportin e punës për gjashtëmujorin e parë të vitit 2026 e prezantoi Kryetari i Komunës së Prizrenit, Shaqir Totaj. Në fjalën e tij, ai përshëndeti të pranishmit, duke iu drejtuar qytetarëve dhe

anëtarëve të Kuvendit Komunal, dhe theksoi se gjatë kësaj periudhe Komuna e Prizrenit ka vazhduar punën me përkushtim në përmbushjen e objektivave të saj zhvillimore dhe përmirësimin e cilësisë së jetës së qytetarëve.

Kryetari Totaj bëri të ditur se gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2026, angazhimi institucional është përqendruar në realizimin e projekteve infrastrukturore, përmirësimin e shërbimeve në arsim dhe shëndetësi, mbështetjen e zhvillimit ekonomik dhe bujqësisë, si dhe promovimin e kulturës, sportit dhe shërbimeve publike cilësore. Ai theksoi se një rëndësi e veçantë i është kushtuar rritjes së transparencës dhe llogaridhënies institucionale, me qëllim forcimin e besimit të qytetarëve ndaj institucioneve komunale.

Në vijim, Kryetari nënvizoi se Komuna ka vazhduar bashkëpunimin e ngushtë me institucionet qendrore, organizatat vendore dhe partnerët ndërkombëtarë, duke siguruar mbështetje për investime dhe projekte të reja që kontribuojnë në zhvillimin e qëndrueshëm të Komunës së Prizrenit. Ai shtoi se rezultatet e arritura gjatë kësaj periudhe janë fryt i punës së përbashkët të institucioneve komunale, partnerëve dhe vetë qytetarëve.

Aktivitetet e Kryetarit:

Gjatë kësaj periudhe janë zhvilluar dhjetëra takime me qytetarë, organizata joqeveritare, përfaqësues të institucioneve qendrore, ambasada, organizata ndërkombëtare dhe partnerë zhvillimorë.

Kryetari ka marrë pjesë në inaugurime të projekteve kapitale, aktivitete kulturore e sportive, akademi përkujtimore, takime me komunitetin e biznesit dhe vizita të vazhdueshme në terren për mbikëqyrjen e investimeve komunale.

Një rëndësi të veçantë ka pasur bashkëpunimi ndërinstitucional, ku gjatë kësaj periudhe janë nënshkruar marrëveshje dhe memorandume bashkëpunimi me:

- MAPL dhe Helvetas Swiss Intercooperation;
- Preda Plus dhe Integra;
- Agjencinë për Zhvillim Rajonal Jug;
- Innovation and Training Park (ITP);
- IKAF;
- Fondin Kosovar për Eficiencë të Energjisë (FKEE);
- MASHTI;
- The Albanian American Foundation;
- Ministrinë e Zhvillimit Rajonal;
- KRU “Gjakova”.

Këto partneritete krijojnë bazë për investime të reja në zhvillimin ekonomik, arsimin, energjinë, inovacionin dhe administratën komunale.

Zyra e Auditimit të Brendshëm

Gjatë periudhës raportuese janë realizuar:

- 2 auditime të përfunduara;
- 1 raport për zbatimin e rekomandimeve të Auditimit të Brendshëm;
- 1 raport për rekomandimet e Zyrës Kombëtare të Auditimit;
- 1 auditim në proces.
-

Janë audituar subvencionet për mekanizimin bujqësor, obligimet e papaguara dhe procesi i arkëtimit të tatimit në pronë. Janë dhënë rekomandime konkrete për përmirësimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, ndërsa janë mbajtur 2 takime të Komitetit të Auditimit.

Zyra për Integrime Evropiane:

Zyra ka koordinuar zbatimin e obligimeve që burojnë nga Agjenda Evropiane dhe Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit.

Gjatë kësaj periudhe janë koordinuar raportimet e të gjitha drejtorive për PKZMSA dhe janë zbatuar projekte si:

HER FUTURE – fuqizimi ekonomik i grave;

EMPOWERED – përfshirja e personave me aftësi të kufizuara;

projektet e Këshillit të Evropës për qeverisje demokratike.

Përfaqësuesit e zyrës kanë qenë pjesë e Komisionit Komunal për Riintegrim dhe grupeve punuese për hartimin e planeve dhe rregulloreve komunale.

Zyra për Informim:

Njësia për Komunikim me Publikun ka vazhduar të garantojë transparencën institucionale.

Gjatë gjashtëmuorit janë realizuar:

- publikimi i të gjitha vendimeve të Kryetarit dhe Kuvendit;
- publikimi i raporteve financiare;
- publikimi i thirrjeve për subvencione dhe bursa;
- publikimi i njoftimeve zyrtare.
-

Statistika kryesore:

- 75 kërkesa për qasje në dokumente publike të trajtuara brenda afatit ligjor;
- 2 takime publike me qytetarë;
- 3 konsultime publike.
-

Po ashtu është hartuar Plani i Veprimit për Transparencë 2026–2030 dhe janë përgatitur raportimet për performancën komunale dhe transparencën buxhetore.

Zyra Ligjore

Zyra Ligjore ka ofruar mbështetje juridike për Zyrën e Kryetarit dhe të gjitha drejtoritë komunale.

Statistika kryesore:

- 182 vendime të përgatitura për nënshkrim;
- 6 autorizime të proceduara.

Janë përgatitur opinione ligjore, akte administrative dhe dokumentacion për procedura gjyqësore, duke garantuar ligjshmërinë e vendimmarrjes komunale.

Zyra e Burimeve Njerëzore:

Njësia ka administruar proceset e personelit dhe zhvillimin e shërbimit civil.

Statistika kryesore:

- 186 kërkesa të pranuar përmes sistemit Intranet;
- 3,023 komunikime dhe shkresa zyrtare të trajtuara;
- 247 dosje personale të përditësuara në HRMIS;
- 94 dosje të reja të formuara;

- 23 Përgjigjjae për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil.

Gjithashtu janë zhvilluar procedurat e konkurseve, emërimeve dhe vlerësimit të performancës së nëpunësve.

Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim:

Zyra ka vazhduar mbështetjen për komunitetet joshumicë dhe procesin e kthimit të qëndrueshëm. Janë koordinuar projekte me partnerë vendorë dhe ndërkombëtarë, janë mbështetur iniciativat për integrim dhe është punuar në avancimin e barazisë në qasjen ndaj shërbimeve komunale.

Zyra e Prokurimit:

Zyra ka zhvilluar procedurat e prokurimit publik për realizimin e investimeve komunale. Gjatë periudhës raportuese janë zhvilluar procedura për investime kapitale, furnizime dhe shërbime, duke respektuar parimet e transparencës, konkurrencës dhe përdorimit racional të mjeteve publike.

Zyra e Përfaqësuesit Ligjor:

Zyra ka mbrojtur interesat juridike të Komunës në procedurat gjyqësore dhe administrative. Janë përfaqësuar seanca gjyqësore, janë përgatitur Përgjigjjae ndaj padive, ankesa dhe mjete juridike, si dhe është bashkëpunuar me të gjitha drejtoritë për mbrojtjen e interesit publik dhe pasurisë komunale.

Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave:

Gjatë gjashtëmuorit të parë të vitit 2026, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave ka garantuar menaxhim të qëndrueshëm financiar, disiplinë buxhetore dhe realizim të rregullt të obligimeve komunale. Puna është fokusuar në ekzekutimin korrekt të buxhetit, menaxhimin e të hyrave vetanake, kontrollin e shpenzimeve dhe ofrimin e mbështetjes financiare për të gjitha drejtoritë komunale.

Sektori për Buxhet dhe Thesar:

Gjatë periudhës raportuese janë realizuar:

- 1,433 pagesa të ekzekutuara;
- 628 zotime të mjeteve buxhetore;
- 901 pranime të mallrave dhe shërbimeve në sistem;
- 604 aprovime të zotimeve financiare.

Përmes këtij sektori është siguruar funksionimi normal financiar i Komunës dhe realizimi në kohë i pagesave ndaj operatorëve ekonomikë, institucioneve dhe përfituesve të ndryshëm.

Sektori i Financave:

Janë monitoruar vazhdimisht të hyrat vetanake dhe realizimi i buxhetit sipas kategorive ekonomike.

Gjatë kësaj periudhe është punuar në:

- hartimin e raporteve financiare periodike;
- monitorimin e realizimit të buxhetit;
- kontrollin e shpenzimeve;
- menaxhimin e rrjedhës së parasë;
- përgatitjen e raportimeve për institucionet qendrore.

Një rëndësi e veçantë i është kushtuar rritjes së efikasitetit në administrimin e mjeteve publike dhe ruajtjes së stabilitetit financiar të komunës.

Qendra Komunale për Biznese

Qendra Komunale për Biznese ka vazhduar ofrimin e shërbimeve administrative për bizneset dhe investitorët.

Janë trajtuar kërkesat për regjistrime, ndryshime të bizneseve dhe procedura administrative, ndërsa është ofruar mbështetje për zhvillimin e ndërmarrjeve lokale dhe krijimin e një klime më të favorshme për investime.

Drejtoria e Shërbimeve Publike:

Drejtoria e Shërbimeve Publike ka qenë ndër drejtoritë më aktive gjatë kësaj periudhe, duke realizuar investime të shumta infrastrukturore në qytet dhe në fshatrat e Komunës së Prizrenit.

Fokusi kryesor ka qenë përmirësimi i infrastrukturës rrugore, shërbimeve publike dhe hapësirave publike.

Investimet infrastrukturore

Janë realizuar dhe janë në proces dhjetëra projekte në:

- asfaltimin dhe rehabilitimin e rrugëve;
- ndërtimin e trotuareve;
- ndërtimin dhe sanimin e kanalizimeve fekale dhe atmosferike;
- zgjerimin e rrjetit të ndriçimit publik;
- rehabilitimin e urave;
- ndërtimin e mureve mbrojtëse;
- rregullimin e shesheve dhe hapësirave publike.

Përmes këtyre investimeve është përmirësuar ndjeshëm infrastruktura në lagjet urbane dhe vendbanimet rurale.

Mirëmbajtja e qytetit

Gjatë gjashtëmujorit janë realizuar aktivitete të vazhdueshme për:

- mirëmbajtjen e rrugëve;
- mirëmbajtjen e trotuareve;
- mirëmbajtjen e ndriçimit publik;
- mirëmbajtjen e sinjalizimit horizontal dhe vertikal;
- pastrimin e kanaleve dhe lumenjve;
- largimin e deponive ilegale;
- mirëmbajtjen e parqeve dhe sipërfaqeve të gjelbra.

Një rëndësi të veçantë ka pasur mirëmbajtja e infrastrukturës ekzistuese për të garantuar sigurinë dhe funksionalitetin e saj.

Gjelbërimi dhe ambienti

Janë zhvilluar aktivitete të vazhdueshme për:

- mbjelljen e drunjve dekorativë;
- mirëmbajtjen e sipërfaqeve të gjelbra;
- krasitjen e drunjve;
- mirëmbajtjen e parqeve;
- mirëmbajtjen e varrezave publike.

Këto aktivitete kanë kontribuar në përmirësimin e pamjes së qytetit dhe cilësisë së jetës së qytetarëve.

Ndriçimi publik

Është vazhduar zgjerimi dhe mirëmbajtja e rrjetit të ndriçimit publik në shumë lagje dhe vendbanime, duke rritur sigurinë në komunikacion dhe hapësirat publike.

Bashkëpunimi ndërinstytucional

Drejtorja ka bashkëpunuar ngushtë me:

kompanitë publike;

operatorët ekonomikë;

Policinë e Kosovës;

KEDS-in;

KRU "Hidroregjioni Jug";

drejtoritë tjera komunale.

Ky bashkëpunim ka mundësuar realizimin më efikas të projekteve dhe reagimin e shpejtë ndaj kërkesave të qytetarëve.

Përmbledhje

Përmes investimeve në infrastrukturë, mirëmbajtjes së qytetit, zgjerimit të ndriçimit publik, përmirësimit të gjelbërimit dhe bashkëpunimit me institucionet përgjegjëse, Drejtoria e Shërbimeve Publike ka dhënë një kontribut të rëndësishëm në përmirësimin e cilësisë së jetës në Komunën e Prizrenit gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2026.

Drejtorja e Arsimit dhe Shkencës:

Edhe gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2026, arsimi ka mbetur ndër prioritetet kryesore të Komunës së Prizrenit. Puna është fokusuar në ngritjen e cilësisë së mësimdhënies, përmirësimin e kushteve në institucionet arsimore dhe zhvillimin profesional të stafit.

Arsimi parauniversitar

Në komunë kanë vazhduar procesin mësimor të gjitha institucionet e arsimit fillor, të mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë, ndërsa Drejtoria ka monitoruar vazhdimisht zbatimin e planprogrameve, mbarëvajtjen e procesit mësimor dhe respektimin e standardeve të MASHTI-t.

Gjatë kësaj periudhe janë organizuar takime të rregullta me drejtorët e shkollave, aktivet profesionale dhe këshillat drejtues për koordinimin e aktiviteteve dhe përmirësimin e cilësisë së arsimit.

Zhvillimi profesional

Janë realizuar dhjetëra trajnime, seminare dhe punëtori për mësimdhënësit dhe stafin menaxhues, me fokus në:

1. zhvillimin profesional;
2. përdorimin e metodave bashkëkohore të mësimdhënies;
3. arsimin gjithëpërfshirës;
4. sigurinë në shkolla.

Investimet në infrastrukturë

Është investuar në:

1. renovimin e objekteve shkollore;
2. përmirësimin e sistemeve të ngrohjes;
3. mirëmbajtjen e objekteve;
4. pajisje didaktike;

5. rregullimin e oborreve dhe ambienteve sportive.
Janë zhvilluar edhe aktivitete kulturore, shkencore dhe sportive, duke promovuar pjesëmarrjen aktive të nxënësve në jetën shkollore.

Drejtoria e Shëndetësisë:

Shëndeti publik ka vazhduar të jetë një ndër prioritetet kryesore të Komunës.

Përmes Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare dhe rrjetit të QMF-ve dhe AMF-ve janë ofruar shërbime të vazhdueshme për qytetarët.

Aktivitetet kryesore

Gjatë kësaj periudhe janë realizuar:

1. vizita mjekësore ambulatorë;
2. shërbime specialitike në kujdesin parësor;
3. vaksinime sipas kalendarit shtetëror;
4. kontrole parandaluese;
5. aktivitete të edukimit shëndetësor.

Është punuar në:

1. furnizimin me barna dhe material shpenzues;
2. mirëmbajtjen e pajisjeve mjekësore;
3. përmirësimin e infrastrukturës së objekteve shëndetësore;
4. ngritjen profesionale të stafit shëndetësor.

Njëkohësisht është bashkëpunuar me Ministrinë e Shëndetësisë dhe partnerët ndërkombëtarë në realizimin e programeve për mbrojtjen dhe promovimin e shëndetit publik.

Drejtoria e Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor:

Drejtoria ka vazhduar zbatimin e politikave të planifikimit urban dhe zhvillimit të qëndrueshëm të territorit të Komunës.

Aktivitetet kryesore

Gjatë periudhës raportuese janë trajtuar:

- kërkesat për leje ndërtimore;
- pëlqimet urbanistike;
- dokumentacioni planifikues;
- procedurat për zhvillim urban.

Është vazhduar puna në:

- dokumentet e planifikimit hapësinor;
- koordinimin me institucionet përgjegjëse;
- mbrojtjen e interesit publik;
- kontrollin e zhvillimit urban.

Përmes këtyre aktiviteteve është krijuar bazë për zhvillim më të planifikuar dhe më të qëndrueshëm të qytetit dhe vendbanimeve rurale.

Drejtoria e Inspektorateve::

Drejtoria e Inspektorateve ka vazhduar zbatimin e ligjit dhe mbikëqyrjen e rregullit publik në të gjitha fushat e përgjegjësisë së saj.

Inspektorati Komunal

Janë realizuar inspektime të vazhdueshme për:

- lirimimin e hapësirave publike;
- kontrollin e pastërtisë;
- largimin e uzurpimeve;
- trajtimin e ankesave të qytetarëve.

Inspektorati i Ndërtimit

Janë kryer kontrole të objekteve në ndërtim, me fokus në:

- parandalimin e ndërtimeve pa leje;
- zbatimin e lejeve ndërtimore;
- ndërprerjen e punimeve të kundërligjshme;
- inicimin e procedurave administrative.

Inspektorati i Tregut

Janë realizuar kontrole të operatorëve ekonomikë për:

- respektimin e kushteve ligjore të ushtrimit të veprimtarisë;
- mbrojtjen e konsumatorit;
- kontrollin e dokumentacionit;
- funksionimin e tregjeve dhe lokaleve afariste.

Në rastet kur janë evidentuar parregullsi janë shqiptuar masa administrative dhe janë lënë afate për eliminimin e tyre.

Bashkëpunimi ndërinstitucional

Drejtorja ka bashkëpunuar ngushtë me Policinë e Kosovës, Inspektoratin Qendror dhe drejtoritë komunale, duke reaguar ndaj kërkesave të qytetarëve dhe duke forcuar zbatimin e ligjit në territorin e Komunës së Prizrenit.

Drejtorja e Administratës:

Gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2026, Drejtorja e Administratës ka siguruar funksionimin e pandërprerë të administratës komunale dhe ofrimin e shërbimeve efikase për qytetarët.

Shërbimet Administrative

Drejtorja ka koordinuar punën e të gjitha sektorëve administrativë, duke garantuar funksionimin e rregullt të sporteleve komunale dhe administrimin e dokumentacionit zyrtar.

Janë ofruar shërbime për:

- regjistrimin civil;
- gjendjen civile;
- legalizimin e dokumenteve;
- pranimin dhe shpërndarjen e shkresave;
- arkivimin e dokumentacionit.
-

Është vazhduar digjitalizimi i proceseve administrative dhe përmirësimi i shërbimeve elektronike për qytetarët.

Teknologjia Informative

Sektori i TI-së ka garantuar funksionimin e sistemeve informatike të komunës.

Janë realizuar:

- mirëmbajtja e serverëve;
- administrimi i rrjetit informatik;
- mbështetja teknike për të gjitha drejtoritë;
- mirëmbajtja e pajisjeve kompjuterike;
- mbrojtja e të dhënave dhe sistemeve elektronike.

Drejtoria e Gjeodezisë dhe Kadastrit:

Drejtoria ka vazhduar administrimin e evidencës kadastrale dhe ofrimin e shërbimeve pronësore për qytetarët.

Gjatë periudhës raportuese janë trajtuar kërkesat për:

- regjistrimin e pronave;
- ndarjen dhe bashkimin e parcelave;
- ndryshimet kadastrale;
- identifikimin e parcelave;
- lëshimin e dokumentacionit kadastral.

Po ashtu është punuar në harmonizimin e bazës së të dhënave dhe përmirësimin e efikasitetit të shërbimeve për qytetarët.

Drejtoria e Punës dhe Mirëqenies Sociale:

Gjatë gjashtëmuorit të parë të vitit 2026, Drejtoria ka vazhduar mbështetjen për familjet dhe individët në nevojë, përmes Qendrës për Punë Sociale dhe programeve të mbrojtjes sociale.

Qendra për Punë Sociale

Janë trajtuar raste nga fusha e mbrojtjes së fëmijëve, dhunës në familje, kujdestarisë, mbështetjes sociale dhe bashkëpunimit me institucionet e drejtësisë.

Statistikat kryesore:

- 70 raste të fëmijëve të përfshirë në punë të rënda ose viktima të trafikimit;
- 75 raste asistimi në Policinë e Kosovës, Prokurori dhe Gjykata;
- 59 raste të dhunës në familje;
- 45 raste të fëmijëve me sjellje asociale;
- 37 raste të referuara nga Prokuroria;
- 27 raste të kërkesave për kujdestari;
- 12 raste të urdhërmbrojtjeve;
- 9 raste të vendosjes së fëmijëve në familje strehuese.

Për secilin rast janë ofruar shërbime profesionale përmes vizitave në terren, këshillimit psiko-social, ndërmjetësimi institucional dhe hartimit të raporteve profesionale.

Drejtoria e Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik:

Gjatë kësaj periudhe është vazhduar puna për promovimin e Prizrenit si destinacion turistik dhe për krijimin e kushteve më të favorshme për zhvillimin ekonomik lokal.

Turizmi

Janë organizuar dhe mbështetur aktivitete për promovimin e trashëgimisë kulturore, monumenteve historike dhe potencialeve turistike të komunës.

Është bashkëpunuar me organizata vendore dhe ndërkombëtare për zhvillimin e projekteve turistike dhe për promovimin e ofertës së Prizrenit.

Zhvillimi Ekonomik

Drejtoria ka punuar në:

- mbështetjen e bizneseve lokale;
- promovimin e investimeve;
- bashkëpunimin me odat ekonomike;
- aplikimin në projekte zhvillimore;
- koordinimin me partnerët ndërkombëtarë.

Përmes këtyre aktiviteteve është synuar rritja e punësimit, zhvillimi i ndërmarrjeve lokale dhe krijimi i një mjedisi më të favorshëm për investime.

Drejtoria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

Edhe gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2026, Drejtoria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural ka vazhduar mbështetjen e fermerëve dhe zhvillimin e sektorit bujqësor, me synim rritjen e prodhimit vendor dhe përmirësimin e kushteve të jetesës në zonat rurale.

Programet mbështetëse

Në kuadër të programeve komunale janë realizuar:

- shpallja dhe administrimi i thirrjeve për subvencione;
- monitorimi i përfituesve;
- shpërndarja e mekanizmit bujqësor dhe pajisjeve sipas kriterëve;
- këshillimi profesional i fermerëve.
-

Gjithashtu është bashkëpunuar me Ministrinë e Bujqësisë dhe organizata donatore për realizimin e projekteve zhvillimore në sektorin rural.

Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit:

Prizreni ka vazhduar të jetë një nga qendrat më aktive kulturore dhe sportive në Kosovë.

Gjatë kësaj periudhe janë organizuar ose mbështetur dhjetëra aktivitete kulturore, artistike dhe sportive.

Aktivitetet kryesore

Janë realizuar:

- aktivitetet për 17 Shkurtin – Ditën e Pavarësisë;
- ceremonia e hapjes së Prizrenit – Qytet Evropian i Sportit;
- manifestimet e Festës së Qershorit;
- aktivitetet për Ditën e Çlirimit të Prizrenit;
- Bunar Fest 2026;

- ekspozita artistike;
- promovime librash;
- koncerte;
- shfaqje teatrore;
- aktivitete për fëmijë dhe të rinj.
- Sporti
- Komuna ka vazhduar mbështetjen financiare dhe organizative për klubet sportive.
- Janë organizuar pritje zyrtare për sukseset e:
- KB Bashkimi;
- KBF Bashkimi;
- sportistëve individualë.

Po ashtu është vazhduar investimi në infrastrukturën sportive dhe monitorimi i punimeve në objektet sportive komunale.

Drejtoria e Pronës dhe Çështjeve Ligjore:

Drejtoria ka vazhduar administrimin e pronës komunale dhe mbrojtjen e interesit pronësor të Komunës.

Janë realizuar:

- administrimi i pronës komunale;
- evidentimi i pasurisë;
- procedurat për dhënien në shfrytëzim të pronës;
- bashkëpunimi me Agjencinë Kadastrale dhe institucionet tjera;
- trajtimi i çështjeve pronësore.

Qëllimi kryesor ka qenë mbrojtja e pasurisë komunale dhe krijimi i bazës ligjore për realizimin e projekteve zhvillimore.

Drejtoria e Tatimit në Pronë:

Drejtoria ka vazhduar administrimin e tatimit në pronë dhe përmirësimin e bazës së të dhënave.

Aktivitetet kryesore kanë përfshirë:

- evidentimin e pronave të reja;
- përditësimin e regjistrit të tatimpaguesve;
- trajtimin e kërkesave të qytetarëve;
- verifikimet në terren;
- përmirësimin e arkëtimit të tatimit.

Përmes këtyre aktiviteteve është synuar rritja e të hyrave vetanake të Komunës dhe përmirësimi i disiplinës fiskale.

Drejtoria për Emergjenca dhe Siguri:

Drejtoria ka vazhduar koordinimin e të gjitha aktiviteteve që lidhen me mbrojtjen dhe sigurinë e qytetarëve.

Aktivitetet kryesore

Janë realizuar:

- monitorimi i situatave emergjente;
- koordinimi me Agjencinë e Menaxhimit të Emergjencave;
- bashkëpunimi me Policinë e Kosovës;

- bashkëpunimi me Shërbimin e Zjarrfikjes;
- hartimi dhe përditësimi i planeve operative;
- reagimi në raste të fatkeqësive natyrore dhe emergjencave civile.

Njëkohësisht janë zhvilluar aktivitete parandaluese dhe ushtrime koordinuese me institucionet përgjegjëse për rritjen e gatishmërisë operacionale.

PËRFUNDIME

Të nderuar qytetarë,

Gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2026, Komuna e Prizrenit ka realizuar një numër të konsiderueshëm aktiviteteve dhe projektesh në të gjitha fushat e përgjegjësisë së saj.

Administrata komunale ka funksionuar me fokus në:

- zhvillimin e infrastrukturës publike;
- përmirësimin e arsimit dhe shëndetësisë;
- rritjen e cilësisë së shërbimeve komunale;
- mbështetjen e bujqësisë dhe zhvillimit ekonomik;
- promovimin e kulturës, rinisë dhe sportit;
- mbrojtjen sociale;
- forcimin e transparencës dhe llogaridhënies.

Në të njëjtën kohë është zgjeruar bashkëpunimi me institucionet qendrore dhe partnerët ndërkombëtarë, duke krijuar mundësi të reja për investime dhe zhvillim.

Projektet e realizuara gjatë kësaj periudhe përbëjnë një bazë të rëndësishme për vazhdimin e investimeve gjatë gjashtëmujorit të dytë të vitit 2026.

Përkushtimi ynë mbetet që Prizreni të vazhdojë të zhvillohet si një komunë moderne, transparente dhe me shërbime cilësore për çdo qytetar, duke investuar në infrastrukturë, kapital njerëzor dhe zhvillim të qëndrueshëm.

Kërkesat/komentet e qytetarëve:

1-Lazer Kajtazi nga fshati Karashingjergj, problem me plehun e shpezëve dhe bagëti, fqi këtë pleh e hedh tek prona ime.

Përgjigjja: drejtoresha e inspeksionit kërkesën tuaj do të shqyrtoj me seriozitet dhe do të respektohen të gjitha procedurat në mënyrë që problemi që ju keni të evitohet.

3-Allmir Bajtami, kryetar i këshillit të fshatrave Mushnikovë, Sreckë, Gornje Sello, Prevallë:

3.1-Punësmi nga pakicat që jetojnë në komunë të Prizrenit.

Përgjigjja: Nga të dhënat që ka komuna punësimi nga pakicat qëndron mirë, punësimi nga të gjitha komunitetet do të vazhdojë duke e respektuar edhe legjisllacionin në fuqi.

3.2-Probleme me energji elektrike.

Përgjigjja: Sipas mundësive buxhetore do të merremi me këtë problem në mënyrë që ato fshatra të mos keni probleme me energji elektrike, ajo çka është në përgjegjësinë e komunës do të rregullohet, por nëse është në përgjegjësinë e institucioneve tjera, kjo do të adresohet.

3.3-Hapja e konkursit për gjuhë shqipe në fshatin Gornje Selo.

Përgjigjja: Sipas mundësive ligjore do të hapet konkursi, por ju që ka shkurtim të orëve mësimore dhe rrjedhimisht mund të ketë edhe shkurtim të numrit të mësimdhënësve.

3.4-Prona e uzurpuara në Prevallë, lirohen ato prona.

Përgjigjja: Drejtoria e Pronave e themeluar gjatë kësaj periudhe raportuese do të merret me të gjitha problemet që kanë qytetarët me prona, në mënyrë që të evitohen telashet që mund të vijnë si pasojë q'uzurpimeve.

3.5-Mos lejimi i vendosjes së rampës për në Prevallë

Përgjigjja: Kjo është temë që i takon nivelit qendrorë por se çka i takon nivelit lokal ajo do të bëhet sipas legjislacionit në fuqi.

3.6-Shpërndaja e Buxhetit në mënyrë racionale.

Përgjigjja: Me aq sa kemi mundësi buxhetore, shpërndarja bëhet e njëjtë si në qytet gjithashtu edhe nëpër fshatra nuk ka kurrfarë tendence në ndarjen e buxhetit.

4-Kujtim ...: Uzurpimi i pronës në rrugën Xhafer Vehapi në Prizren.

Përgjigjja: Drejtoria e Pronës do të merret me kërkesën tuaj dhe do të shikohen të gjitha mundësitë që të evitohet problemi që keni Ju.

5.Shani Tanaj, kryetar i këshillit të fshatrave: Mazrek, Kojushë, Planej, Milaj dhe Gorozhup: Pastrimi i rrugës Gjonaj-Gorozhup.

Përgjigjja: Komuna e Prizrenit ka kontratë me EkoRegjionin dhe do të shikohen mundësitë që kjo rrugë të pastrohet sa më shpejt që është e mundur.

Shënjëzimi horizontal dhe vertikal i rrugës Gjonaj-Gorozhup.

Përgjigjja: Komuna ka kontratë për shënjëzimin vertikal dhe horizontal dhe sipas mundësive buxhetore do të angazhohet edhe operatori të kryej punët aty ku kërkohet nga ana e qytetarëve.

6-Behajdin Berisha, lagjja e Trimave në qytetin e Prizrenit: Rregullimi i rrugës në lagje.

Përgjigjja: Edhe pse komuna është në vështirësi financiare por që prap po punohet sigurisht që do të punohet për rregullimin e rrugës edhe në lagjen e Trimave.

7-Nexhat Gashi, drejtor i shkollës në shkollën në fshatin Atmaxhë: Rregullimi i kulmit të shkollës pasi që kur po bie shi uji po hyn brenda në shkollë.

Përgjigjja: Me buxhet është e paraparë rregullimi i kulmit dhe do të shohim edhe mundësitë financiare për të rregulluar kulmin pasi që është e nevojshme rregullimi i tij.

8-Bajram Gashi, Takim mujor me qytetarë.

Përgjigjja: Ne vazhdimësi qytetarët priten në takim nga kryetari, drejtoret dhe zyrtaret tjerë, ne këto takime diskutohen tema të rëndësishme me qytetarë për lagjet dhe fshatrat prej nga vijnë.

9-Shkri Quni, kryetar i këshillit të fshatrave Nashec dhe Grazhdanik: të mbrohet prona publike-shoqërore në fshatin Grazhdanik.

Përgjigjja: Drejtori i Drejtorisë së Pronës do të merret me këtë çështje dhe do të mbrohet prona ashtu siç edhe e thonë ligjet që janë në fuqi. Mbrojtja e pronës është obligim ligjorë.

10-Simon Veseli, kryetar i këshillit të fshatrave Velezhë, Sërbicë e Epërme, Trepetnicë, Shpenadi dhe Smaç:

10.1 Rregullimi i një pjese të objektit të shkollës në Velezh.

Përgjigjja: Është e planifikuar dhe do të rregullohet ajo pjesë e objektit.

10.2 Pastrimi i Lumit Korishë-Shpenadi.

Përgjigjja: Është pastruar, sigurisht që ka nevojë edhe për pastrim edhe më tutje, do të shikohen mundësitë financiare dhe të punohet edhe në atë projekt.

10.3 Ndarja e subvencioneve.

Përgjigjja: Ndarja e subvencioneve bëhet bazuar në kriteret ligjore, ata që i plotësojnë kriteret marrin mbështetje financiare.

10.4 Shtatorja për Nënë Terezën.

Përgjigjja: Është punuar në këtë pikë me personat përgjegjës dhe do të punohet edhe me tutje deri në realizimin e projektit.

11.Ramë Himaj, kryetar i këshillit të fshatrave Romaj dhe Lukinjë:

10.1 Rregullimi i varrezave në fshatin Romajë.

Përgjigjja: Ky projekt është përmes buxhetimit me pjesëmarrje, projekti do të realizohet duke e shikuar edhe mundësinë buxhetore.

10.2 Rregullimi i rrugëve në fshatin Romajë.

Përgjigjja: Komuna ka kontrata me operator, do të shikohen mundësitë buxhetore dhe do të realizohet ky projekt.

17-Jeton Zogaj, OJQ Shqiptaria, ndryshimi emrave në harta.

Përgjigjja: Ndryshimet në harta janë përgjegjësi e institucioneve të nivelit qendror, por ajo çka ka mundësi niveli lokal i kryen ashtu siç kërkohen edhe me legjislacionin në fuqi.

Shpejtim Canaj, kryetar i këshillit të fshatrave Kushtendin, Lubiqevë Leskovec dhe Lez: Ndërtimi i fushës sportive në fshatin Lybeqeve.

Përgjigjja: Ndërtimi i fushës do të jetë në projeksionet buxhetore.

Kryetari Shaqir Totaj dhe drejtorët që ishin të pranishëm në takim, u Përgjigjën të gjitha pyetjeve dhe komenteve të të parashtruara nga të pranishmit në takim.

Takimi ka përfunduar në orën 11:45.

Për të siguruar transparencë dhe informim të plotë të publikut, dokumenti-raporti i Takimit të Parë Publik të Kryetarit të Komunës, Shaqir Totaj, u janë shpërndarë në formë fizike të gjithë pjesëmarrësve në takimin publik.

Njëkohësisht, raporti për punën 6-të mujore është publikuar në faqen zyrtare dhe kanë qenë të qasshme për të gjithë qytetarët përmes vegëzave përkatëse:

<https://prizren.rks-gov.net/takimet-publike/> dhe https://prizren.rks-gov.net/wp-content/uploads/2026/06/Raporti-i-Punes-se-Kryetarit-Janar-Qershor-2026_compressed.pdf

Me 30.06.2026, është mbajtur takimi publik, vegëza e publikimit të lajmit për mbajtjen e takimit:

Në webfaqe:

<https://prizren.rks-gov.net/news/kryetari-shaqir-totaj-prezantoi-raportin-e-punes-per-gjashtemujorin-e-pare-per-vitin-2026/>

Facebook:

<https://www.facebook.com/share/p/1994qK1cBD/>

Në këtë vegëz: <https://www.facebook.com/TVBESA/videos/3178799542309011/> , mund ta gjeni vegëzën e transmetimit në kohë reale të takimit me qytetë.

Procesmbajtës:


Haziz Krasniqi